

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

KREATX

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L12121023B

NUIS/NIPT

Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2

Adresa

Tiranë

Albania

1026

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672001454

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@kreatx.com

E-mail

Administrator Enor Nakuçi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2024/02/29

Data (viti/muaji/dita)

0672001454

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-92678-12-29-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.*

SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

144333300

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/02/05

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2024/02/05

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/24791/12292023

48444100-350312300-850312600-1

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

a) Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Nenet 2,3,77,36

b) VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“ Per Miratimin E Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmëri)

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Në datë 03.01.2024 është shpallur procedura me numer reference REF-92678-12-29-2023 nga Autoriteti Kontraktor SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane, me objekt te sajën “Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”, me fond limit 144.333.300 (njqind e dyzet e kater milion e treqind e tridhjte e tre mije e treqind) lekë pa tvsh. Afati i fundit per pranimin e ofertave e percaktuar nga autoriteti kontraktor ka qene 05.02.2024 10:00.

Per kete procedure eshte bere ankimi administrativ Nr aplikimi të ankesës online: A/2024/3748 Date 11.01.2024 per dokumentat e tenderit. Pas shqyrtimit te kesaj ankese nga autoriteti kontraktor UK Tirane dhe KPP eshte marre vendimi perfundimtar nga KPP me Nr. 169/2024, Date 13/02/2024 sipas te cilit autoriteti kontraktor duhet te modifikojte dokumentat e tenderit konform ketij vendimi dhe per te konfirmuar kete vendim autoriteti kontraktor duhet te publikoje nje shtojce ku te pasqyrohen ndryshimet. Ne daten 21.02.2024 AK ka publikuar ”Shtojcen per modifikim Date 21.02.2024”. Ne kete shtojce AK ka pretendon qe ka kryer te gjitha ndryshimet qe duhet te beheshin sipas vendimit te KPP. Deri ne momentet e kesaj ankese procedura e mesiperme vijon te mbetet ne statusin ”Pezulluar”.

Pasi kemi analizuar me kujdes permbajtjen e kesaj shtojce konstatojme qe ndryshimet e kryera perseri jane evaive,jo te sakta dhe gjithashtu krijojne konfuzion te operatoret ekonomike te interesuar.

Ndryshimet jane totalisht ne shkelje te hapur te Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“ Per Miratimin E Rregullave të Prokurimit Publik”, duke ulur gjithepershirjen e operatoreve ekonomike dhe per rrjedhoje duke zvogeluar konkurencen dhe eficencen e procedures se prokurimit.

Bazuar ne afateve ligjore te percaktuara ne nenin 110 pika 1 te Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 97 pika 1 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“ Per Miratimin E Rregullave të Prokurimit Publik” paraqesim ankesen njekohesisht SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Ne nenin 2 te Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet :

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficienten dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ne Nenin 3 “Parime te Pergjithshme” te Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet :

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për

operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Ne Nenin 77 pika 1 dhe 4 te Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se :

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që të shërbejë autoritetin kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varesi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e vecanta për kualifikim në varesi të volumit si dhe të natyrës së kontratës, me qëllimin e krijimit të një panorame sa më të qartë për kapacitetet teknike dhe profesionale që zotërojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të tillë që të provojnë dhe të garantohen se këto të fundit zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Megjithatë, pavarësisht qëllimit kryesor të autoritetit kontraktor që të provojë dhe të garantohet se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, vlerësojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesa proporcionale në varesi të volumit si dhe të natyrës së kontratës duke u bazuar në një analizë të detajuar në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën dhe të maksimizojë efikasitetin e procedurës së prokurimit.

Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.a ka percaktuar ne “Shtojcen per modifikim Date 21.02.2024” ndryshimin e kriterit si meposhte :

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:

- ? 1 (një) punonjës të certifikuar për zbatime sistemesh ERP
- ? 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukture cloud
- ? 1 (një) punonjës të certifikuar për raportim të tipit BI
- ? 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator e bazës së të dhënave
- ? 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin ORACLE ;
- ? 2 (dy) punonjës te certifikuar për zhvillim në web/mobile;

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a.Kontratën e punës

b.Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Sqarim:Bazuar ne vednimin e KPP – se nr 169/2024 date 13.02.2024 do te behet unifikimi i ketij kriteri ne gjuhen e huaj(Angleze)

In the Other special qualification criteria in point 2.7, it is requested:

Was;

2.7. The economic operator must have, at least the last 3 (three) months from the date of publication of the contract notice, technical personnel, who will engage in the implementation of the project, having combined knowledge according to the following criteria:

- ? 1 (one) certified employee for ERP systems implementation
- ? 1 (one) employee certified for cloud infrastructure systems
- ? 1 (one) employee certified for BI type reporting
- ? 1 (one) certified employee for database administrator
- ? 2 (two) employees certified for AL-Billing system or equivalent;
- ? 2 (two) employees certified for web/mobile development;

An employee may hold more than one attestation.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operators must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

a. The employment agreement

b. Relevant certificates. In case the certificates are in a foreign language, the economic operator must present them translated according to the applicable legal provisions in force.

c. Payroll of the last 3 months.

Note: For the above points, the bidding economic operators must submit the self-declaration form

according to appendix no. 9.

In any case, the CA shall be hereby entitled to carry out the necessary verifications on the authenticity of the information declared by the economic operator or to ask the economic operator for clarifications and supporting documents for such clarifications.

Note: The first qualified economic operator must submit to the CA, before the publication of the winner's announcement and the start of the appeal deadlines, all the evidentiary documentation for the self-declarations in the self-declaration summary form.

It shall Become:

2.7. The economic operator must have, at least the last 3 (three) months from the date of publication of the contract notice, technical personnel, who will engage in the implementation of the project, having combined knowledge according to the following criteria:

? 1 (one) certified employee for ERP systems implementation

? 1 (one) employee certified for cloud infrastructure systems

? 1 (one) employee certified for BI type reporting

? 1 (one) certified employee for database administrator

? 2 (two) employees certified for ORACLE system;

? 2 (two) employees certified for web/mobile development;

An employee may hold more than one attestation.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operators must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

a. The employment agreement

b. Relevant certificates.

c. Payroll of the last 3 months.

Note: For the above points, the bidding economic operators must submit the self-declaration form according to appendix no. 9.

In any case, the CA shall be hereby entitled to carry out the necessary verifications on the authenticity of the information declared by the economic operator or to ask the economic operator for clarifications and supporting documents for such clarifications.

Note: The first qualified economic operator must submit to the CA, before the publication of the winner's announcement and the start of the appeal deadlines, all the evidentiary documentation for the self-declarations in the self-declaration summary form.

Shoqeria "Kreatx" shpk nisur nga shtojca per modifikim e dates 21.02.2023 konstaton qe AK perseri e ka lene evasive dhe te paqarte kriterin:

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:

- 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin ORACLE ;

Me konkretisht po rendisim arsyetimet tona lidhur me kete kriter :

Arsyetimi 1

Gjate shqyrtimit te ketij kriteri mund te vihet re qartesisht qe AK dhe pas modifikimit sipas vendimit te KPP, perseri ky kriter nuk eshte shoqeruar me termin "ose ekuivalent". Mungesa e ketij togfjaleshi e ben kriterin diskriminues, dhe te paperputshem me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Arsyetimi 2

Terminologjia e perdorur nga AK per kete kriter eshte e gabuar dhe qartesisht e pabazuar. Me konkretisht sjellim ne vemendje qe ORACLE nuk eshte sistem por eshte emri i nje kompanie e cila ofron shume sisteme te ndryshme dhe ne nje hulumtim ne faqen zyrtare te kompanise ORACLE mund te shikohen qe ofrohen produktet qe vijon. Bashkengjitur kesaj ankese eshte edhe kopje e pamjes se faqes zyrtare te ORACLE me produktet dhe certifikatat qe kjo kompani ofron.

Produktet qe ORACLE ofron jane shume te ndryshme nga njeri-tjetri dhe kane qellime te ndryshme perdorimi. Gjithashtu lidhur me keto produkte, vete ORACLE ofron certifikata profesionale te ndryshme. Ato mund te shikohen edhe ne dokumentin bashkengjitur kesaj ankese ku gjenden produktet dhe certifikatat qe ofrohen en faqen zyrtare te ORACLE.

Hartimi i kriterit ne menyre te tille ben qe OE e interesuar mund te paraqesin cfaredo lloj certifikate te leshuar nga ORACLE, per shembull mund te paraqese nje certifikate per sistemin Human Capital Management qe eshte nje sistem i ORACLE por qe nuk lidhet me objektin e kesaj procedure dhe me kerkesat teknike te saj. Gjithashtu duhet te theksojme qe ne kete menyre dhe AK mund te sillet me certifikatat e depozituara nga OE te ndryshem sipas deshirave te saj dhe mund te kualifikojë ose skualifikojë sipas rastit dhe pa u bazuar ne nje kriter specifik.

### Arsyetimi 3

Konstatojme qe edhe pas “Shtojces per modifikim Date 21.02.2024” AK nuk ka kryer ndryshimet e nevojshme ne procesverbalin e argumentimit sipas ndryshimeve te kryera. Ne procesverbain e argumentimit vijon te mbetet argumentimi per kete kriter “Punonjësit e çertifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni AL-Billing nevojitet për zhvillimin, pershtajen si dhe permiresimin e sistemit AL-Billing. Kjo kerkese bazohet ne termat e references se projektit ku operatori duhet të jetë në gjëndje të përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga UKT.” kurse argumentimi ne gjuhen angleze eshte “AL-Billing application development and maintenance certified employees are needed for the development, adaptation and improvement of AL-Billing system. This criterion is based on the terms of reference of the project where the operator must be able to adapt the program to important components required by UKT.”

Pra sic mund te konstatohet lehtesisht argumentimi vijon te mbetet i njejte si ne anglisht dhe ne shqip ne kundërshtim me ndryshimin e kryer per kete kriter. Perseri jemi ne kushtet e krijimit te konfuzionit per kete kriter, menyren se si do te plotesohet dhe lidhja logjike midis kriterit dhe argumentimit te tij.

Per sa cituam me lart mbeshtetur ne bazen ligjore te cituar dhe gjithshu ne arsyetimet tona kerkojme ndryshimin e kriterit te mesiperme dhe ne kete ndryshim te percaktohen qarte :

- 1- Certifikimi i sakte ORACLE qe kerkohet sipas objektit te kesaj kontrate ose ky kriter te hiqet fare nese nuk ka rendesi per AK.
- 2- Nese do te kerkohet nje certifikim, ai te shoqerohet me togfjaleshin “ose ekuivalente” sipas parashikimeve ligjore
- 3- Te gjitha ndryshimet ne kete kriter te pasqyrohen gjithashtu ne procesverbalin e argumentimit duke evituar cdo keqinterpretim

Bashkengjitur kesaj ankese dokumentacioni si meposhte :

- 1- Ankesa UK Tirane dhe KPP e formatuar me nenshkrim elektronik
- 2- Kopje e pamjes se website zyrtar te ORACLE



**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

Nuk ka

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

Nuk ka

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

info@kreatx.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Enor Nakuçi